

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoratur me titull "Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Serbinë", të kandidatit Mr. Sc. Mehmet Kalisi me e nr .16-102/2 të datës 22.02, Komisioni në përbërje: 1. Prof. Dr. Qani Nesimi, 2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani, 3. Prof. Dr. Metush Sulejmani, 4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, dhe Prof. Dr. Ibish Kadriu, pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit filozofik i paraqet këtë:

R A P O R T

për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës

Të dhënat biografike të kandidatit:

Mehmet Kalisi është lindur më 22/02/1971 në fsh.Seçishtë në Komunën e Hanit të Flezit, Republika e Kosovës, ku ka kryer edhe shkollimin fillor ndërsa shkollimin e mesëm e ka të kryer në Prishtinë.

Studimet themelore i ka regjistruar në vitin 1998 në drejtimin Gazetarisë drejtimi Radio dhe Televizion, në Universitetin Al Imam Muhammed Ibn Saud në Riad të Arabisë Saudite duke i përfunduar ato me sukses në Janar të vitit 2002, dhe duke fituar kështu titullin akademik: Bachelor në Gazetari- Radio dhe Televizion.

Si student ai ka shfaqur një angazhim të gjerë akademik duke iu besuar edhe detyra e kryetarit të klubit të Unionit të Studentëve Shqiptar, nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi, të cilët studiojnë në Riad.

Duke filluar nga viti 2006 kandidati Mehmet Kalisi, angazhohet bashkëpunëtor i kanalit televiziv Al-Jazeera në fushën e produksionit të dokumentarëve nga Ballkani, ndërsa nga viti 2008 deri në vitin 2016 ishte bashkëpunëtor i kanalit televiziv BBC Arabic si analist dhe komentator për çështet e ballkanit. Kandidati Mehmet Kalisi ka qenë aktiv edhe në media tjera si analist dhe komentator siç janë: Radio Monte Carlo dhe MBC me seli në Dubai.

Pas kryerjes së studimeve themelore, kandidati Mehmet Kalisi në vitin akademik 2013/2014 ka regjistruar ciklin e dytë të studimeve, në fushën e Shkencave të Komunikimit pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" Instituti për hulumtime sociologjike dhe politiko juridike

ku në shtator të vitit 2018 e mbron me sukses temën “**Studim komparativ për raportimin e rtk live në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze**” dhe fiton titullin magjistër i shkencave të komunikimit.

Studimet e doktoratës në programin studimor Sociologjisë, moduli Socio-politik i ka regjistruar në vitin akademik 2018/19 në Universitetin e Tetovës nën udhëheqjen e Prof. Dr. Ibish Kadriut, në temë: “**Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Sërbinë**”, të miratua nga Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Filozofik-Universiteti i Tetovës, me numër 16-351/4 të 25.06.2020.

Gjatë kësaj periudhe të studimeve të doktoraturës kandidati Mehmet Kalisi i ka kryer me sukses provimet e doktoraturës, konferencat doktorale, dhe obligimet tjera të parapara me Rregulloren për studimet e doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

Në vitin 2020, Mehmet Kalisi pranohet si asistent i jashtëm në Universitetin e Tetovës në Fakultetin Filozofik, programi studimor Sociologjisë.

Publikimet shkencore:

- **Memet Kalisi&Ibish Kadriu** The Role of Social Media in the Family Communication of Youth in Kosovo, **PHILOSOPHICA**, Vol. 7 | No. 13-14. 2020. pp. 79-85. Print ISSN: 1857-9272, Online ISSN: 2671-3020.
- Memet Kalisi, Relation Between Reliability Towards Social Media with the Scale of Credibility of Information on Kosovo-Serbia Dialogue **PHILOSOPHICA**, Vol. 8 | No. 15-16, 2021. pp. 49-59. Print ISSN: 1857-9272 Online-ISSN: 2671-3020.

Pjesëmarrjet dhe referimet në konferencat shkencore:

- Konferencë ndërkombëtare Shtypi islam, dje, sot dhe nesër. Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë Kosovë Shtator 2003.
- International Conference, Balkan Reality and Challenges, Al Jazeera Center for Studies: Doha, Qatar, 2011.
- Migration, Reasons, Motives and Consequences in the Society 6th International Conference, University of Tetova. 2019.
- International interdisciplinary Conference: Comparative Studies in Modern Society: Balkans in European and Global Context., University Ukshin Hoti in Prizren, Kosovo 2021

- Education and Culture in Contemporary Society, International interdisciplinary Conference, University Fan S. Noli, Korçë, Albania 2021.

Pasqyrë e aktiviteteve të realizuara nga kandidati gjatë studimeve të doktoratës:

Kandidati Mr. Sc. Mehmet Kalisi që nga fillimi i studimeve në ciklin e tretë të doktoraturës e këndeje, ka dëshmuar interes dhe progres të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe të punimit të disertacionit të doktoraturës. Ai me sukses ka realizuar tri konferencat doktrale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Gjatë kësaj periudhe ka botuar punime, artikuj shkencor në revista ndërkombëtare të fushës dhe ka marrë pjesë në disa konferenca shkencore vendore dhe ndërkombëtare.

Analizë e punimit të doktoratës: " Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Serbinë"

Ky disertacion i doktoraturës ka një ndarje të përgjithshme prej dy pjesësh, pjesa e parë teorike dhe pjesa e dytë empirike.

Disertacioni i doktoraturës është i strukturuar në pesë kapituj, sipas çështjeve që trajtohen dhe metodologjisë së shfrytëzuar, duke ju përmbajtur udhëzuesit për shkrimin e disertacionit të doktoraturës të Universitetit të Tetovës.

Disertacioni i doktoraturës fillon më pjesën e hyrjes e cila merret me parashtrimin fushës së studimit, dhe me kriteret e rëndësisë së objektit të studimit. Gjithashtu trajton çështjen e marrë për studim, detyrën shkencore, informacionet e rëndësishme, strukturën e punimit dhe dobinë e rezultateve të tij.

Kapitulli i parë:

Këtë kapitull kandidati e ndërton mbi një analizë dhe kritikë të literaturës së përzgjedhur për të ngritur shtratin teorik ku do të aplikohen, përgjatë kapitujve përmbyllës, si të gjetjet empirike ashtu dhe përfundimet. Janë përcaktuar dy teori si më të përshtatshme për këtë punim: Teoria Agenda Setting dhe Teoria e Sferës Publike. Në këtë pjesë studimi jep përcaktime teorike mbi kontekstin historik në lidhje me fillimin e bisedimeve Kosovë-Serbi dhe zhillimet në Kosovë, njëherit duke theksuar ecurinë e marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në këtë

kapitull pjesa tjetër flet për mediat sociale dhe shfaqja e tyre, definimin e tyre dhe roli i tyre në procesin e komunikimit, karakteristikat dhe veçoritë komunikative të tyre, ndikimet dhe efektet negative të mediave sociale në shoqëri. Konsideratat për median sociale në cilësinë e hulumtimeve. Rëndësi të veçantë në këtë pjesë i kushtohet edhe krijimit të opinionit publik, definimin teorik, rëndësia e tij dhe llojet e opinionit publik. Roli i medive sociale në formësimin e opinionit publik dhe faktorët të cilët ndikojnë në krijimin e opinionit publik.

Kapitulli i dytë:

Në këtë kapitull kandidati pasqyron kornizën metodologjike të hulumtimit, siç janë detyra shkencore, hipotezat ose pyetjet kërkimore, subjekti i kërkimit, procedura e përcaktimit të kampionit të studimit, metodat kërkimore, instrumentet dhe procedura e hulumtimit, kulizimet e kërkimit dhe kriteret etike të përdorura në studim.

Kapitulli i tretë:

Duke përdorur paketën statistikore të shkencave sociale SPSS, doktoranti paraqet gjetjet e studimit nga të dhënat e përpunuara. Në këtë pjesë janë paraqitur pasqyra e testeve statistike të të dhënave me interpretimet përkatëse, të cilat i referohen objektivave të përcaktuara të studimit.

Kapitulli i katërt:

Përfshinë diskutimin e gjetjeve duke krahasuar të dhënat e konstatuara të këtij studimi me pjesën teorike dhe studimet e ngjashme. Ky seksion përmban krahasimin e gjetjeve me pika të caktuara referimi, hipotezat, pyetjet kërkimore dhe interpretimin e rezultateve. Rezultatet e analizës së të dhënave janë krahasuar me rezultatet e përfituara nga studiuesit e tjerë ose të diskutuara në kontekstin e hipotezave. Gjithashtu, në këtë pjesë janë paraqitur kritika për çështjen e marrë për studim dhe janë bërë komente.

Kapitulli i pestë:

Përfshinë në mënyrë taksative përfundimet e hulumtimit. Ky seksion përmban përfundimet kryesore të studimit dhe rekomandime a propozime konkrete.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura:

Disertacioni i doktoraturës me titull: “**Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Sërbinë**”, shfrytëzon metodologji që është e ndarë sipas problemit të hulumtimit. Rrjedha metodologjike e këtij studimi, është realizuar me metode korrelacionale të të dhënave sasiore të grumbulluara përmes instrumenteve matëse të zhvilluara për grumbullimin e të dhënave të nevojshme për gjetjet e këtij studimi. Në këtë pjesë në mënyrë kronologjike janë pasqyruar objektivat e studimit, problemi dhe pyetjet kërkimore, hipotezat, analizat e karakteristikave matëse të instrumenteve, përkufizimet konceptuale dhe operacionale të variablave të studimit, metodat statistikore të përpunimit të të dhënave, fazat e grumbullimit të të dhënave dhe kriteret etike të studimit.

Ky disertacion qëllim kryesor ka patur të verifikoj relacionin mes shkallës së perceptimit të rolit të mediave sociale, gjegjësisht përdorimit të mediave sociale me opinionin apo qëndrimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës ndaj dialogut Kosovë-Serbi.

Në këtë pjesë është bërë saktësisht qasja konceptuale e këtij studimi, ndaj variablave të studimit, gjegjësisht rolin e mediave sociale. Studimi ka synuar të përfshijë disa dimensione që i referohen informacionit në mediat sociale.

Përpos variablave kryesore me dimensionet përkatëse që ka trajtuar ky studim, janë përfshirë dhe testuar edhe variabla tjera relevante apo kontrolluese, për të parë efektet e tyre në relacion me ato kryesore. Pas shpjegimit të qasjes konceptuale të variablave të studimit, në vijim është prezantuar qasja operacionale e matjes së variablave, gjegjësisht shëndërrimit në natyrë sasiore.

Popullata e synuar e këtij studimi kanë qenë të gjithë qytetarët shqiptarë të Republikës së Kosovës prej moshës 18 vjeçare, të cilët janë përdorues të rrjeteve sociale. Kampioni i studimit është zgjedhur në mënyrë të rastësishme në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, me interval të besueshmërisë 95%, interval të saktësisë në ± 4 , numri i grupeve (38-komuna), përqindja e vlerësuar e variancës 50/50 dhe numri i pritur i mos përgjigjeve ($N*1.05$). Prej gjithsej 583 subjekte të planifikuar për të marrë pjesë në studim, gjithsej pozitivisht 528 subjekt i janë përgjigjur këtij studimi, gjegjësisht me efikasitet të kënaqshëm prej 90.57%. Në studim nuk janë përfshirë

subjektë të cilët nuk kanë qenë përdorues të rrjeteve sociale mbi moshën 18 vjeçare. Numri i përdoruesve të rrjeteve sociale është siguruar nga të dhënat zyrtare të rrjetit sociale Facebook për Republikën e Kosovës gjatë procedurës së aplikimit të instrumentit. Numri i meshkujve të cilët kanë marrë pjesë në studim është 393 ose 74.43%, ndërsa ai i femrave 135 apo 25.57%. Pjesëmarrësit me vendbanimet rurale janë gjithsej 191 apo 36.17%, ndërsa 337 pjesëmarrës nga qyteti me 63.83%.

Instrumenti për matjen e perceptimit të rolit të mediave sociale

Matja e shkallës së perceptimit të rolit të mediave sociale është realizuar përmes instrumentit në formë shkalle të zhvilluar nga autori studimit me gjithsej 30 pyetje në formë të deklaratave me kahje të kombinuar pozitive dhe negative, të cilat gjatë zhvillimit janë përshtatur me përmbajtjen konceptuale të dukurisë së caktuar. Për matjen e pohimeve është aplikuar shkalla e Likertit prej 0 (aspak nuk pajtohem) deri 4 (plotësisht pajtohem). Pas krijimit të pohimeve instrumenti i është nënshtruar face vlefshmërisë, me qëllim të formulimit më të saktë të pyetjeve në të cilat ky studim ka synuar të merr të dhëna.

Instrumenti për matjen e opinionit për dialogun Kosovë-Serbi

Matja e opinionit për dialogun Kosovë-Serbi është realizuar me një instrument të zhvilluar nga doktoranti me gjithsej 24 pyetje në formë të pohimeve dhe shkallë të matjes prej 0 (aspak nuk pajtohem) deri 4 (plotësisht pajtohem). Zhvillimi i instrumentit ka kaluar fazat paraprake të konsultimit dhe face vlefshmërinë, duke synuar që të gjitha pyetjet të rezultojnë në një identitet të përbashkët dhe përfshirjen e vlefshmërisë së përmbajtjes.

Aplikimi i instrumentit është realizuar prej 27 shkurt deri 11 mars 2021, online në rrjetet sociale përmes financimit në rrjetin social Facebook. Financimi i pyetësorit është realizuar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës në përputhje me evidencat zyrtare të përdoruesve për vendet e caktuara, përmes faqes zyrtare "Dailogue" të krijuar për në përputhje me standardet përkatëse.

Pyetësori është publikuar me të dhënat e studiuesit dhe me adresë komunikimi për çështje të caktuara. Kjo teknikë e grumbullimit të të dhënave është aplikuar me qëllim të ruajtjes së anonimitetit të pjesëmarrësve, përfshirjes më të madhe të popullsisë në studim, natyrës së variablave të kërkimit shkencor të cilat kanë të bëjnë për përdorimin e rrjeteve sociale dhe si rezultat i kufizimeve nga pandemia Covid 19. Në këtë formë realizuesi i studimit nuk ka pasur

ndikim të pjesëmarrësit e studimit, ku të gjithë pjesëmarrja ka qenë në formë vullnetare, duke eliminuar kërcënimin e vlefshmërisë përmes familjarizimit me respondentët.

Platforma ka përcaktuar saktë që përcjellja e pyetësorit të bëhet në mënyrë të barabartë, duke siguruar shanse të barabarta për pjesëmarrje në studim, njëherit duke ruajtur anonimitetin e të gjithë pjesëmarrësve. Në kuadër të pyetësorit janë aplikuar teknika të kontrollit për të mënjnuar respondentë të papërshtatshëm për studimin. Pjesëmarrësve iu është garantuar anonimiteti, e drejta e pjesëmarrjes vullnetare dhe tërheqja nga studimi deri në momentin e dërgimit. Autori i studimit iu është përgjigjur pyetjeve të ndryshme dhe paqartësive që kanë pasur respondentët gjatë plotësimit të pyetësorit. Ky studim për nga mbledhja e të dhënave ka qenë **“double blind”**, për shkak se autori i studimit nuk ka pasur qasje në të dhënat gjatë procesit të grumbullimit, dhe të njëjtën e ka realizuar person tjetër përgjegjës me kompetenca të plota profesionale.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit:

Në mënyrë që rezultatet e këtij hulumtimi të jenë relevante, dhe të lidhura ngushtësisht me temën që trajtohet: **“Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Serbinë”**, është dashur që të ngritën hipotezat, dhe pyetjet e parashtruara gjatë formulimit të tezës së doktoraturës. Në varësi nga segmentet që trajtojnë hipotezat e ngritura janë përdorur edhe metodat përkatëse ashtu që të arrihet në rezultate më të sakta.

Përgjigjet e pritura të pyetjeve kërkimore të studimit të cilat kryesisht janë edhe të bazuara në pikëpamjet teorike dhe studimet e ngjashme, janë të paraqitura në formë të hipotezave në mënyrë alternative si vijon:

1. Ekziston ndërlidhje pozitive mes shkallës së përgjithshme të perceptimit të rolit të mediave sociale në jetën e qytetarëve të Kosovës dhe opinionit të tyre për dialogun Kosovë-Serbi.
2. Nëse roli i mediave sociale në jetën e qytetarëve të Kosovës rritet, atëherë do të rritet edhe shkalla e ndryshimit të opinionit ndaj dialogut Kosovë-Serbi.
3. Ekziston ndërlidhje pozitive mes dimensioneve të mediave sociale dhe opinionit të qytetarëve për dialogun Kosovë-Serbi.
 1. Me rritjen e shkallës së përdorimit të mediave sociale, rritet ndryshimi i opinionit të përgjithshëm për dialogun Kosovë-Serbi.
 2. Rritja e nivelit të lidhjes emocionale me mediat sociale, shoqërohet me rritjen e ndryshimit të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.

3. Me rritjen e besueshmërisë së lajmeve në mediat sociale, ndryshon në aspekt pozitiv edhe opinionit për dialogun.
4. Shkalla e pozitive e qëndrimeve ndaj mediave sociale, shoqërohet me nivel më pozitiv të opinionit për dialogun.
4. Nëse do të rriten pozitivisht dimensionet e mediave sociale, atëherë edhe opinionit ndaj dialogut Kosovë-Serbi do të orientohet pozitivisht:
 1. Nëse do të rritej përdorim i mediave sociale, atëherë do të rritej edhe ndryshimi i opinionit për dialogun.
 2. Nëse lidhja e emocionale me mediat sociale do të rritej, atëherë do të rritej edhe ndryshimi i opinionit për dialogun.
 3. Nëse do të rritej besueshmëria ndaj mediave sociale, atëherë do të rritej pozitivisht edhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.
 4. Nëse qëndrimet ndaj mediave sociale do të shënonin ngritje pozitive, atëherë edhe opinionit ndaj dialogut do të ndryshojë në pikëpamje pozitive.
5. Ekziston relacion pozitiv mes shkallës së njohjes së procesit të dialogimit, bindjeve ndaj dialogut, pritshmërive për rezultatin e dialogut, besimit ndaj dialogut dhe ndjenjës së refuzimit për dialogun Kosovë-Serbi me shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale.
 1. Te qytetarët të cilët niveli i njohjes ndaj procesit të dialogut është i lartë, aq më i lartë është edhe roli i mediave sociale;
 2. Rritja pozitive e rolit të mediave sociale te qytetarët shqiptarë të Kosovës shoqërohet me rritje të pritshmërive pozitive për rezultatin e dialogut;
 3. Me rritjen e besueshmërisë ndaj dialogut Kosovë-Serbi, rritet edhe roli pozitiv i mediave sociale;
6. Roli i mediave sociale është parashikues i rëndësishëm i dimensioneve të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi. Nëse do të rritej pozitivisht roli i mediave sociale, atëherë do të ndryshonte me tendencë rritjeje edhe niveli i nivelit të njohjes së procesit të dialogimit, bindjeve, besimit ndaj dialogut, pritshmërive dhe ndjenjës së refuzimit të dialogut.
7. Ekziston relacion pozitiv mes dimensioneve të shkallës së përgjithshme të rolit të mediave sociale si: përdorimit të mediave sociale, lidhjen emocionale me mediat sociale, besueshmërinë e lajmeve në mediat sociale, njohjen apo bindjet ndaj mediave sociale me

- dimensionet e opinionit për dialogun Kosovë-Serbi si: niveli i njohjes së procesit të dialogimit, bindjet, besimi ndaj dialogut, pritshmëritë dhe ndjenja e refuzimit të dialogut.
8. Ekzistojnë dallime gjinore në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale me dimensionet përkatëse dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.
 1. Meshkujt shfaqin nivel më të lartë në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale dhe dimensionet si: përdorimit të mediave sociale, lidhjen emocionale me mediat sociale, besueshmërinë e lajmeve në mediat sociale, njohjen apo bindjet ndaj mediave sociale, për dallim prej femrave;
 2. Meshkujt shfaqin nivel më të lartë pozitiv të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi dhe dimensionet si: niveli i njohjes së procesit të dialogimit, bindjet, besimi ndaj dialogut, pritshmëritë dhe ndjenja e refuzimit të dialogut, për dallim prej femrave.
 9. Ekzistojnë dallime sipas llojit të vendbanimit në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale me dimensionet përkatëse dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.
 - a. Qytetarët nga vendet urbane shfaqin nivel më të lartë në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale dhe dimensionet si: përdorimit të mediave sociale, lidhjen emocionale me mediat sociale, besueshmërinë e lajmeve në mediat sociale, njohjen apo bindjet ndaj mediave sociale, për dallim prej atyre nga vendbanimet rurale;
 - b. Qytetarët e vendbanimeve urbane shfaqin nivel më të lartë pozitiv të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi dhe dimensionet si: niveli i njohjes së procesit të dialogimit, bindjet, besimi ndaj dialogut, pritshmëritë dhe ndjenja e refuzimit të dialogut, për dallim prej atyre nga vendbanimet rurale;
 10. Ekzistojnë dallime sipas nivelit të shkollimit të përlunduar (arsim fillor, i mesëm, fakultet, magistraturë/doktoraturë) në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale me dimensionet përkatëse dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.
 11. Ekzistojnë dallime sipas statusit të punësimit (i/e punësuar, i/e pa punë, i/e vetë punësuar) në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale me dimensionet përkatëse dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.
 12. Ekzistojnë dallime sipas fondit të orëve të frekuentimit aktiv të mediave sociale (deri 1 orë, 2-4, 5-6, 7 e më shumë) në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale me dimensionet përkatëse dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.

13. Ekzistojnë dallime sipas mënyrës së qasjes së qytetarëve ndaj informacionit në mediat sociale, në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale me dimensionet përkatëse dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi.

14. Ekziston lidhje pozitive mes moshës së pjesëmarrësve dhe shkallës së rolit të mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi

Duke u bazuar në objektivat dhe synimin e këtij studimi, ky disertacion i doktoraturës ka rënditur edhe pyetjet kërkimore të cilave ky studim ju jep përgjigje përmes procedurave përkatëse metodologjike. Të gjitha pyetjet kërkimore i referohen qytetarëve shqiptarë të Republikës së Kosovës.

1. Cila është ndërlidhja mes shkallës së përgjithshme të perceptimit të rolit të mediave sociale në jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës me opinionin e tyre për dialogun Kosovë-Serbi?
2. Cila është përmasa parashikuese e ndryshimit të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi nga mediat sociale në Republikën e Kosovës?
3. A ekziston lidhje mes shkallës së përdorimit të mediave sociale me opinionin e qytetarëve për dialogun Kosovë-Serbi?
4. A ekziston ndërlidhje mes lidhjes emocionale me mediat sociale dhe opinionin e qytetarëve për dialogun Kosovë-Serbi?
5. A ekziston lidhje mes besueshmërisë së lajmeve në mediat sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi?
6. A ekziston marrëdhënie e rëndësishme mes aspektit të njohjes apo bindjeve ndaj mediave sociale me opinionin ndaj dialogut Kosovë-Serbi?
7. Cila është përmasa e forcës parashikuese të përdorimit të mediave sociale ndaj opinionit për dialogun Kosovë-Serbi?
8. A ndryshojnë opinionet ndaj dialogut Kosovë-Serbi nga shkalla e lidhjes emocionale me mediat sociale?
9. Cili është efekti i parashikimit të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi nga besueshmëria e lajmeve në mediat sociale?
10. A ekziston lidhje mes dimensioneve të shkallës së përgjithshme të rolit të mediave sociale si: përdorimit të mediave sociale, lidhjen emocionale me mediat sociale, besueshmërinë e lajmeve në mediat sociale, njohjen apo bindjet ndaj mediave sociale me dimensionet e

- opinionit për dialogun Kosovë-Serbi si: niveli i njohjes së procesit të dialogimit, bindjet, besimi ndaj dialogut, pritshmëritë dhe ndjenja e refuzimit të dialogut?
11. Çfarë përmase parashikuese ndaj ndryshimit të opinionit për dialogun Kosovë-Serbi ka natyra e njohjes apo bindjet që qytetarët kanë për mediat sociale?
 12. A ekziston ndërlidhje mes shkallës së njohjes së procesit të dialogimit, bindjeve ndaj dialogut, pritshmërive për rezultatin e dialogimit, besimit dhe ndjenjës së refuzimit të dialogut Kosovë-Serbi me shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale në jetën e qytetarëve të Kosovës?
 13. Çfarë efekti parashikues ndaj nivelit të njohjes së procesit të dialogimit, bindjeve, besimit ndaj dialogut, pritshmërive dhe ndjenjës së refuzimit të dialogut Kosovë-Serbi ka roli i mediave sociale?
 14. A ekzistojnë diferenca në shkallën e përgjithshme të rolit të mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi sipas gjinisë së qytetarëve të Kosovës?
 15. A ekzistojnë dallime sipas llojit të vendbanimit të përhershëm të qytetarëve të Kosovës në shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi?
 16. A ekzistojnë dallime në shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi sipas nivelit të shkollimit të përfunduar?
 17. A ekzistojnë dallime në shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi sipas statusit të punësimit?
 18. A ekzistojnë dallime në shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi sipas llojit të mediave sociale të cilat frekuentohen më shumë nga qytetarët?
 19. A ekzistojnë dallime në shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi sipas fondit të orëve të frekuentimit të mediave sociale?
 20. A ekzistojnë dallime në shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi sipas mënyrës së gjetjes apo qasjes së qytetarëve ndaj informacionit në mediat sociale?
 21. A ekziston ndërlidhje me shkallën e përgjithshme të rolit mediave sociale dhe opinionit për dialogun Kosovë-Serbi me moshën?

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit:

Tema që trajton kandidati Mr. Sc. Mehmet Kalisi në këtë disertacion doktore, Kjo tezë doktore synon të hulumtoj mediat e sociale dhe rolin e tyre në krijimin e opinionit publik të Kosovës në kontekst të marrëveshjes paqësore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky studim ka si objekt analizimin e rolit të medias sociale në procesin e prodhimit, shpërndarjes dhe konsumimit të informacionit. Në mënyrë të detajuar studimi synon të analizojë rolin e rrjeteve sociale nga ana e qytetarëve të Kosovës, dhe cilët janë efektet e mediave sociale për krijimin e opinionit publik në Kosovë mbi këtë çështje. Teoria e krahasuar e fushës është sidomos e rëndësishme për hetuar segmentet të cilat pak ose fare nuk janë trajtuar në studimet e deritashme, apo cilat pyetje të cilat kanë mbetur pa përgjigje. Në këtë disertacion të doktoraturës kandidati ka shfrytëzuar burime teorike dhe pikëpamje socio-kulturore dhe politike mbi problemin e hulumtimit, për të gjetur dallimet dhe kundërshtitë konceptuale mbi rolin e mediave të sociale me theks në Republikën e Kosovës.

Hulumtime të mundshme në të ardhmen:






Tema e disertacionit të doktoraturës **“Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Sërbinë”** përfshin një studim të gjerë, por edhe specifik të koncepteve të shumta aplikuar por pak të njohura shkencërisht në Republikën e Kosovës. Prandaj, kandidati ose edhe studiues të tjerë mund të trajtojnë shumë çështje të veçanta që prek ky disertacion.

Kandidati ka bërë përpjekje të çështje të zhvillimit të mediave sociale në Republikën e Kosovës, që implikon edhe zhvillimin e përgjithshëm social. Prandaj, çështjet e ngritura në këtë disertacion janë një kontribut jo vetëm për sferën e sociologjisë politike, që ndërlidhet me krijimin e opinioneve të shumta kjo si pasojë e zhvillimit mediatic, ndryshimin e mendimit të gjerë social për çështje të caktuara etj. Por, ky disertacion i doktoraturës mund të shërbejë për hulumtime shkencore në sferën e komunikimit dhe të mediave, gjithashtu duke parë ecurinë e bisedimeve kosovë - serbi ky disertacion mundë tu shërbej edhe institucioneve shtetërore të Kosovës në komunikimin e tyre me publikun nëpërmjet mediave sociale. Gjithashtu do të ishte me interes të veçantë të ripërsëritej edhe njëherë i njëjti studim për shkak të ndryshimeve të mëdha politike para dhe pas këtij disertacioni.

Vlerësim dhe rekomandim:

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës së doktoratës “**Roli i mediave sociale në krijimin e opinionit në Kosovë në kontekst të marrëveshjes me Sërbinë**”, të kandidatit Mr. Sc. Mehmet Kalisi, ka nderin që t’i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe krijimin e kushteve për mbrojtjen publike të kësaj teme të doktoratës.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Qani Nesimi, Kryetar  :
2. Prof. Dr. Abdylnaser Sinani, anëtar  :
3. Prof. Dr. Metush Sulejmani, anëtar  :
4. Prof. Dr. Kushtrim Ahmeti, anëtar  :
5. Prof. Dr. Ibish Kadriu, mentor  :

Tetovë, 2022